

VENDIM
Nr. 206, datë 9.4.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
OBJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË (NGA
PUSHPIMET E ÇERMËS, DEGËZIMI NË KAVAJË, DERI NË DEPON E RE,
ARAPAJ, LOTI III)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë (nga pusshpimet e Çermës, degëzimi në Kavajë, deri në depon e re, Arapaj, loti III)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë bujqësore me sipërfaqe 5 482 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) m², me vlerë të përgjithshme prej 1 858 229 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 197 000 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 858 229 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, zëri “Investime”.

6. Shpronësimi të fillojë më 21.4.2014.

7. Pronarët e pasurive për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e planit të objektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe, me nisjen e procesit të likuidimit, të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së planit të objektit mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIME
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË(NGA PUSHPIMET E CERMËS, DEGËZIMI NË KAVAJË
DERI NË DEPON E RE ARAPAJ, LOTI III)

Nr.				Nr. i pas	ARË			Shënime
1	Sabri	Kacmolli	1031	119/11	3701	339	1254605	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Ramazan	Kacmolli	1031	119/14	1781	339	603623	Konfirmuar nga ZRPP-ja
			SHUMA		5482		1858229	